

BULETIN

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

funded by
Sida

“TË MËSOJMË DUKE PUNUAR” - METODA E MUSPP-IT NË QASJEN E “BËRJES VET” TË DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT DHE PROJEKTEVE

Që ngaviti 2006, komuna të ndryshme në Kosovë janë mbështetur në fushën e planifikimit urban dhe hapësinor nga programet për mbështetjen e komunave në planifikim hapësinor (MuSPP) të financuara nga Sida dhe inpleemntuar nga UN-HABITAT-i. Në fazën e saj të parë, nga 2006-2008 Programi u fokusua në asistencën në punë dhe në dhënien e këshillave për drejtoritë komunale të planifikimit në qeveritë lokale si dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane. Faza e dytë e Programit u zhvendos në mbështetjen direkte të komunave në hartimin e planeve urbane/komunale dhe projekteve të dizajnit urban me angazhim të plotë të stafit të MuSPP-it dhe atij komunal. Ekipet e MuSPP-it, përbërë nga stafi komunal dhe stafi lokal dhe ndërkombëtar i UN-HABITAT-it janë të vendosura në pesë komuna të mëdha (Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, dhe në tri komuna të reja, të dala nga procesi i decentralizimit (Juniku, Hani i Elezit dhe Mamusha). Mungesa e stafit dhe buxhetit në komunat e vogla kërkon përpjekje dhe angazhim të shtuar, dhe me këtë rast Programi i MuSPP-it dhe stafi i tij është i angazhuar me kohë të plotë dhe në këtë mënyrë edhe rodi qasja e “hartimit në shtëpi (vet)” të planeve komunale. Qasja “në shtëpi” e angazhon stafin e MuSPP-it dhe atë komunal të punojnë së bashku në baza ditore duke e aplikuar metodën “të bëjmë duke mësuar” në procesin e planifikimit për hartimin e planeve komunale, urbane dhe atyre rregulluese si dhe të projekteve për investime kapitale. Kjo metodë shërben si mjet për ngritjen e kapaciteteve, e rrit pronësinë dhe ka kosto efektive për komunat. Kjo përfshin shumë palë nisur nga organizatat lokale që sigurojnë mbledhje të dhënash më efektive dhe më të besueshme, por edhe qendrore si Instituti për Planifikim Hapësinor brenda Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, që është përfshirë në ndërtimin e skenarëve për punëtorë dhe mbështetjen e zhvillimit të punëtorëve tematike gjatë procesit të hartimit. Në disa komuna, është krijuar Sistemi Gjeografik Informativ ku stafi komunal është aftësuar në përgatitjen e hartave për planet komunale. Pjesëmarrja publike, përfshirja e akterëve të ndryshëm në proceset e planifikimit dhe transparenca janë principet kryesore të qeverisjes së mirë që aplikohet në procesin e hartimit të planeve dhe projekteve në komunat e MuSPP-it. Për më shumë, kjo metodë e punës kontribon në përfundimin e bashkëpunimit në mes të komunave dhe përfaqësuesve të komunitetit të shoqërisë civile, qeverisë qendrore si dhe bizneseve publike dhe private. Për më tepër, efektet pozitive të mënyrës përfshirëse të punës mund të shihen në fuqizimin e shoqërisë civile përmes krijimit të asociacioneve dhe OJQ-ve të grave në komuna. Një atribut tjetër i programit është kuptimi i qasjes së

planifikimit strategjik hapësinor duke e aplikuar atë në praktikë, që çon në fuqizimin e aftësive organizative dhe menaxheriale të sfafit komunal të involvuar. Zhvillimi i sensit të pronësisë dhe dëshira për të më



Hani i Elezit



Mamusha



Juniku

suar më shumë nga këto procese janë vlerë shtesë e metodës “të mësojmë duke punuar”. Marrë parasysh këto, duke i zhvilluar politikat dhe projekte të planifikimit “në shtëpi (vet)”, Programet e MuSPP-it shfaqin zgjidhje alternative për hartimin e PZHK/PZHU-ve dhe PRU-ve në krahasim me praktikën e aplikueshme deri tani të angazhimit të kompanive private. Qasja “në shtëpi” nënkupton më pak harxhime për komunën dhe vë në funksion optimal ekspertizën profesionale të stafit të involvuar në proceset e planifikimit duke ngritur kështu edhe mundësitë perspektivën për zbatim të planeve. Për këtë qëllim nevojitet, një angazhim i madh i komunave dhe donatorëve në këtë mënyrë të punës, prandaj vlerësimi i kapaciteteve njerëzore të përfshira ka rëndësi vendimtare.

Lumnije Gashi,
Zyrtare në UN-HABITAT/ MuSPP

Turneu Kulturor



më shumë në fq11

Editorial



Të nderuar lexues

Kam kënaqësinë të ju lancoj edicionin e ri të Buletinit të MuSPP. Informata mbi Programin për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal ka qenë i mundshëm në webfaqen www.unhabitat-kosovo.org që nga fillimi i programit. Me këtë edicion, ne vendosëm të përmbledhim një publikim në formë të shtypur Buletini që të sigurohemi të arrijmë edhe tek ata të cilët nuk kanë qasje të rregullt në internet ose zakonisht nuk informohen përmes webfaqes. Ky Buletin përmban përmbledhje të zhvillimeve të rëndësishme në muajt e fundit, për Pogramin e Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal dhe agjencisë së tij implementuese UN-HABITAT-it. Buletini prezanton tranzicionin e MuSPP

nga Programi me nota këshillëdhënëse në atë më të fokusuar në mbështetje të drejtpërdrejtë për komunat e vogla, në përpilimin e planeve të tyre, si dhe prezanton skenarët për ballafaqim me sfidat e shekullit 21.

Kjo përvojë do të ndahet edhe më vonë në publikimet e ardhshme.

Këtu do të gjeni raportin e detajuar e vizitës në Suedi, bërë nga kryetarët e komunave të programit MuSPP në Majin e kaluar. Qëllimi e kësaj vizite ishte të familjarizojë pjesëmarrësit me sistemin e qeverisjes lokale suedeze, organizimin dhe funksionimin e saj, rolet dhe përgjegjësitë dhe me theks të veçantë në çështjet zhvillimore strategjike.

Një ndër çështjet themelore në UN-HABITAT ishte zgjedhja e Joan Clos si Drejtori i ri ekzekutiv i kësaj organizate nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Gushtin e këtij viti. Në fjalimin e tij pranues, Z. Closs tha që është i nderuar të jetë i zgjedhur në këtë pozitë, si dhe u përkushtua për ndërtimin mbi të arriturat e paraardhëses së tij z. Anna Tibajuka. Tetori ishte muaji ku u festua Dita Botërore e Habitat-it. Buletini përmban edhe artikullin për Tour de Culture i organizuar për të tretën herë në Kosovë. Ngjarja shënoi një rekord të ri dhe mblodhi më shumë se 300 pjesëmarrës dhe ishte një kombinim i ciklizmit rekreativ dhe vizitës në vendet interesante kulturore dhe natyrore përgjatë rrugës së saj. Buletini raporton edhe në prezantimet e punës së MuSPP-it në platformën ndërkombëtare, përfshirë konferencën e Real Corp në Vjenë. Gjithashtu sjellë raportin mbi Takimin Shqyrtues të nën-

shkruesve të deklaratës së Vjenës për Vendbanimet Joformale, e cila shërbeu si mundësi të prezantojë mbështetjen e MuSPP dhënë njëherë nga komunat partnere në përpilimin e planit rregullues për vendbanimet joformale.

Çështja e vendbanimeve joformale ishte temë e veçantë për diskutim në edicionin e 5-te të Forumit Botëror Urban i mbajtur në Rio De Janeiro, më herët këtë vit, i cili po ashtu është i përfshirë në këtë Buletin. Artikulli i veçantë diskuton mbi çështjet e vlerësimit dhe menaxhimit e rreziqeve, si dhe si adresohet kjo çështje nga MuSPP-i.

Buletini gjithashtu raporton edhe në progresin e Projekteve kapitale të bashkë financuara nga MuSPP-i dhe komunat partnere. Një prezantim i plotë i Projekteve Kapitale do të bëhet veçmas. Buletini përmbillet me letrat e praktikantëve të MuSPP të cilët erdhën në Kosovë nga Australia, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar për t'iu bashkangjitur ekipit të programit dhe të përfitojnë përvojë praktike në planifikim.

Ne shpresojmë që ky edicion i buletinit MuSPP-it do t'ju ofrojë njohuri më të mirë për punën e MuSPP-it dhe t'ju inkurajojë të përcillni aktivitetet e programit në Kosovë.

Krystyna Galezia,

KKT/Udhëheqëse e UN-HABITAT-it, Kosovë



**PËR MË SHUMË:
WWW.UNHABITAT-KOSOVO.ORG**

SUEDIA PRET KRYETARËT E KOMUNAVE TË MUSPP-IT VIZITA STUDIMORE NË SUEDI

Delegacioni prej 16 pjesëmarrësve i përbërë prej kryetarëve të komunave të Kosovës, MMPH, MAPL, dhe AKK dhe MuSPP2/UN-HABITAT kanë ndjekur një vizitë studimore bërë në Suedi nga 25-28 Maj 2010. Pjesëmarrësve iu ofrua mundësia të zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e planifikimit hapësinor dhe menaxhimit mjedisor, ra-

disë, këshillave të qarqeve dhe regjioneve, vijnë nga mbledhja e taksave. 290 komunat e Suedisë janë gjithashtu punëdhënës të mëdhenj, përgjegjës për një pjesë të madhe të shërbimeve publike në fushën e përkujdesjes (për fëmijë dhe parashkollorë, kujdes ndaj pleqve), shërbime sociale, edukim (fillor dhe të mesëm) dhe infrastrukturë (çështje

mjedisore, është i përkushtuar dhe ambicioz për të vazhduar edhe më tej në përmirësim të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, me qëllim që të përmirësojë kualitetin e jetës për qytetarët e tij dhe të reduktojë ndikimin të cilin ai shkakton në mjedisin global. Përfaqësuesit nga zyra e planifikimit të qytetit veçuan dy projekte zhvillimore ambicioze mes 18 sosh, brenda Programit Zhvillimor për Klimë pozitive të Stokholmit. Projekti i parë, Porti Mbretëror Detar ballafaqohet me sfidën e transformimit të portit dhe një zone industriale të ndotur në një ndër zonat më atraktive Evropiane, e cila përfshinë zonën për banim, hapësira për zyre si dhe portin modern. Metodrat e reja dhe teknologjia moderne do të kontribuojnë në uljen e dukshme të gjurmëve të karbonit. Deri në vitin 2030, ky rajon nuk do të përdorë lëndë djegëse me bazë fosile dhe do të jetë pozitiv për klimën. Projekti i dytë, programi "Jarva e qëndrueshme" ka të bëjë me vizionin e Stokholmit të transformojë një paralagje të madhe të zymtë nga paslufta (arkitekturë monotone, të pa mirëmbajtur, me efektshmëri të ulët energjetike, strukturë sociale të izoluar) në një lagje atraktive, me banim që shfrytëzon energji efektive dhe mjedis të llojlojshëm urban. Kushtet e reja urbane mjedisore dhe të banimit do të zhvillohen për "Jarvën e qëndrueshme" duke përfshirë zvoglimin e konsumit të energjisë më shumë se 50%, shfrytëzim më të madh të burimeve të energjisë ripërtëritëse, zhvillimin e transportit të qëndrueshëm, edukimin e banorëve për kursim të energjisë, dhe evaluimin e mjeteve dhe masave të domosdoshme. Pjesëmarrësit e vlerësuan dhe e çmuan vizitën studimore, dhe gjithashtu ishin mirënjohës për mikpritjen dhe gadishmërinë e pritësve të kësaj vizite, për ti shkëmbyer përvojat dhe njohuritë e tyre. Ata theksuan që përkundër mungesës së fondeve dhe ekspertizës në disa fusha, shumë nga "praktikat më të mira" që ishin vëzhguar duhet të konsiderohen për aplikim në Kosovë në nivelin përkatës. Kjo do të ishte e arritshme me përkrahjen e programeve të Sida-s dhe partneriteve tjera.

Sa i përket Kosovës, qëllimi i përgjithshëm i Sida-s është ta ndihmojë atë në Integrimin Evropian dhe të kontribuojë në stabilitetin e shtetit dhe rritjen ekonomike. Duke u bazuar në objektivat parësore të Kosovës, do të adresohen sektorët në vijim: Mjedisit dhe Klima, Edukimi dhe Qeverisja Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut.

Drita Nushi,

Zyrtare në UN-HABITAT/ MuSPP



portin e tyre me zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe mënyrën e funksionimit të marrëveshjeve institucionale në mes të sferave të ndryshme qeveritare dhe subjekteve të ndryshme që veprojnë brenda Suedisë. Programi përbëhej nga një numër i prezenteve informuese dhe vizitave në qytetet e Stokholmit, Gavles, Falunit dhe Borlanges. Delegacioni u prit nga zyrtarët e (SKL/SALAR), Sida, kryetarët e komunave, dhe përfaqësuesit të departamenteve të ndryshme komunale. Prezantimet ishin shumë mirë të përgatitura dhe u shpërndanë shumë materiale informative. Qëllimi kryesor i kësaj vizite profesionale ishte njoftimi me sistemin e Qeverisë lokale Suedeze dhe funksionimin e saj (organizimin komunal, rolet dhe përgjegjësitë, financimin dhe buxhetimin, si dhe çështjet e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve). Suedia ka tri nivele të qeverisë – shtetëror, regjional dhe lokal, të cilat janë të zgjedhura në zgjedhjet e përgjithshme të cilat mbahen në të njëjtën ditë çdo 4 vjet. Qeveria lokale ka traditë të gjatë në Suedi. Komunitetet e vendit, këshillat e qarqeve dhe regjioneve janë përgjegjëse për ofrimin e një pjese të rëndësishme të shërbimeve publike. Ato kanë një nivel të konsiderueshëm të autonomisë dhe autoritetit të pavarur mbi mbledhjen e taksave gjë që u lejon komunave, këshillave të qarqeve dhe regjioneve, të vënë taksat në mënyrë që të mund t'i financojnë aktivitetet e tyre. Mesatarja e përgjithshme e taksave lokale është 30%, prej të cilave 20% shkojnë në komuna dhe 10% në këshillat e qarqeve dhe regjioneve. Përafërsisht dy të tretat e të ardhurave totale të komunave të Sue-

di të planifikimit dhe ndërtimit, mbrojtja e shëndetit dhe mjedisit, menaxhimi i mbeturinave, ujësjellës dhe kanalizim). Programi i vizitës studimore ka vënë theks të posaçëm në çështjet e përgjithshme të zhvillimit strategjik, planifikimit gjithpërfshirës si dhe planifikimit të integruar në nivel detal. Në nivelin shtetëror, Ministria e Mjedisit është përgjegjëse kryesore për planifikim hapësinor. Departamentet shtetërore: Bordi Shtetëror për Banim, Ndërtim dhe Planifikim, Administrata Shtetërore e Hekurudhave, Administrata Shtetërore e Rugëve dhe Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit janë departamente të shtetit përgjegjëse për çështjet e planifikimit hapësinor dhe për formulimin e objektivave të politikave, dokumenteve drejtuese dhe udhërrëfyesve, si dhe monitorimin dhe evaluimin e implementimit të politikave qeveritare. Interes i veçantë i është kushtuar ngritjes së pjesëmarrjes qytetare në çështjet e planifikimit në të gjitha nivelet, si dhe janë zhvilluar mjete dhe metoda të ndryshme që ta mundësojnë këtë, siç janë panelet e qytetarëve përmes komunikimit me TI, dialogu me të rinj, buxheti me pjesëmarrje, shërbime të reja, dialogu në qeverisje, raportet për performancën e komunës etj. Vizita gjithashtu pati për qëllim njoftimin më të përafërt me çështjet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor dhe disa çështje aktuale të regjenerimit urban Stokholmi është përzgjedhur Kryeqyteti i Gjellbër në Europë për vitin 2010 Çmimi Kryeqyteti i Gjellbër European është garë e re vjetore e themeluar nga Komisioni Evropian, ku qyteti fitues i cili ka shënuar suksese të vazhdueshme në arritjen e standardeve të larta

DITA BOTËRORE E HABITATIT '10

FESTIMI I DITËS BOTËRORE TË HABITAT-IT NË MBARË BOTËN

Manifestimi botëror i Ditës Botërore të Habitatit(WHD) për këtë vit do të mbahet në Panairin Botëror të Shangait 2010, në mikrpritje të Ministrisë Kineze për Banim dhe Zhvillim Urban-Rural dhe Komisionit Komunal të Shangait për Ndërtim Rural,Urban dhe Transport. Dita Botërore e Habitat-it do të jetë aktivitet i rëndësishëm i panairit, ku Komitet e Bashkuara e kanë stendën e tyre. Panairi Botëror i Shangait prezenton një vend të mirë për vështrim global, pasi që tema Qytet më i mirë, Jetë më e mirë e bën atë ekspozitën e parë globale dedikuar potencialit dhe problemeve të jetesës urbane të shekullit 21. Kjo ekspozitë do të shfaqë ide të reja mahnitëse që do t'i bëjë qytetet tona vende më të mira për gjeneratat e reja, ku mendohet se 70 përqind të njerëzimit do të jetojnë në të ardhmen në qyteza dhe qendra. Pavijoni i Kombeve të Bashkuara do të zhvillohet nën temën, Një Botë, një KB. Koordinuar nga UN-HABITAT-i si agjensi kryesore për çështjet urbane, e shfaqë më të mirën e saj për bërjen e mjediseve tona urbane, vende më të mira dhe më të mençura kur është në pyetje ulja e varfërisë, krimin, konsumimit të lëndëve djegëse, ndotjes, mbeturinave, dhe shumë sëmundjeve që na brengosin, veçanërisht në botën në zhvillim. Ekspozita do t'i shfaqë njohuritë tona, shumë praktika të mira, dhe bash-

kimin tonë për qëllimin e zhvillimit të Kampanjës Botërore Urbane për qytete më të qëndrueshme për një audiençë të gjerë urbane. Qytete më të mira, Jetë më mirë e nënvizon vizionin tonë për një botë urbane të qëndrueshme që ndërlihet me potencialet dhe mundësitë, zbut pabarazitë dhe ndasitë dhe ofron shtëpi për të gjithë njerëzit e të gjitha kulturave dhe moshave, të pasur dhe të varfër. Manifestimi botëror i Ditës Botërore të Habitat-it do të jetë i lidhur ngushtë me takimin e veçantë për Qytet të Banueshëm në Shoqërinë në Harmoni organizuar nga qyteti i Hangzhou-t dhe bashkëfinancuar nga Zyra e Shangait për koordinimin e Panairit Botëror, Ministria Kineze e Banimit dhe Zhvillimit Urban-Rural si dhe nga UN-HABITAT-i. Kjo është njëra nga takimet e larta ku diskutohet për tema të rëndësishme urbane duke përfshirë qëndrueshmërinë, zhvillimin urban, mjedisin, ekonominë, trashëgiminë kulturore, shkencën dhe arrijtet. Këto diskutime do të përmbillen me forumin e samitit në mbyllje të panairit për arrijtet urbane dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të cilin marrin pjesë liderë botërorë, kryetarë të qyteteve, dhe zyrtarë të tjerë botërorë me rëndësi për botën urbane. Duke u bazuar në temën e Ditës Botërore të Habitatit, çdo vit programet e UN-HABITAT-it në bashkëpunim me qeveritë lokale dhe

qëndrore e shënojnë këtë ditë me aktivitete të ndryshme. Në të shumtën e rasteve WHD-të janë kremtuar me fëmi, ku ata i kanë shprehur pikëpamjet e tyre për të ardhmen e qyteteve përmes vizatimeve dhe shkrimit të eseve. Këtë vit, WHD-ja do të shënohet me konferencën me temë "Qytet më i mirë, Jetë më e mirë". Me mandatin që e ka, UN-HABITAT-i do ta ngris debatin në platformën profesionale përmes kësaj konference që ka për qëllim të dhënies së porosisë për nivelin qendror, që qeveria duhet t'i kushtojë rëndësi urbanizimit të shpejtë që po ndodh në Kosovë dhe në mbarë botën. Konferenca ka për qëllim shkëmbimin e përvojave nga ana e vendeve fqinje, të cilat janë ballafaquar me sfidat e urbanizimit në vitet e fundit.

Në mënyrë tipike, të jetuarit në shtetet në zhvillim dhe të pafuqishme në përgjithësi, pa të drejta të caktuara dhe me popullsi nën moshën 25 vjeçare, të varfërit urban janë shpesh të privuar të jetojnë pa të drejta bazike, shpesh për edukim ose punë të mirë

Sekretari Gjeneral i KB-së, Ban Ki-Moon, 2009

"Sot gjysma e njerëzimit jetojnë në qytete, dhe trendet tregojnë që kjo shifër do të rritet në dy të tretat brenda dy gjeneratave të ardhshme. Kjo është arsyeja pse tema e zgjedhur për Ditën Botërore të Habitat-it, Qytet më i mirë, Jetë më e mirë është aq e rëndësishme për të gjithë ne"

Inga Björk-Klevby, Zyrtare në detyrë e UN-HABITAT-it

Festimi i DBH-së në Kosovë: Nxënësit i prezentuan idetë e tyre për Qytet më i mirë, Jetë më e mirë



Si në shumë qytete në mbarë botën, Dita Botërore e Habitat-it(DBH) u festua edhe në qytetin historik të Prizrenit në Kosovë. Me këtë rast UN-HABITAT-i u bashkua në festimin e kësaj dite së bashku me Komunën e Prizrenit dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Ceremonia e ndarjes së cmimeve u organizua në sallën komunale të Komunës së Prizrenit. Për ta shënuar këtë ditë, prezent ishin përfaqësues të autoriteteteve lokale, nga Programi për Planifikim Hapësinor Komunal i UN-HABITAT-it, OSBE-ja, nxënës të cilët morën pjesë në garën për shkrimin e eseve, mediat si dhe përfaqësues të organizatave të

tjera ndërkombëtare. Aktiviteti filloi me fjalët hyrëse nga ana e organizatorëve, të cilët i nënvizuan çështjet dhe problemet me të cilat ballafaqohet jeta në zonat urbane në shekullin e 21. Po ashtu në fokus u vë nevoja e zhvillimit të qasjeve të mençura, të reja dhe atyre përfshirëse në adresimin e sfida të urbanizimit. Të gjithë nxënësit u nderuan me certifikata për pjesëmarrjen në këtë garë por gjithashtu edhe patën mundësi që esetë e tyre t'i lexojnë para audiençës së mbledhur në Sallën Komunale të Prizrenit. Nga kjo, u zhvillua një debat interaktiv, ku nxënësit patën mundësi t'u shtrojnë pyetje autoriteteteve komunale për shqetësimet, planet dhe

mangësitë e vizionit komunal për projektet lokale si dhe në çështje tjera urbane. Esetë kishin të bënin me një varg çështjesh globale, si: ngrohja globale, efekti i zonave të gjelbëra, mungesa e transportit publik urban, banimi social, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, burimet alternative të energjisë, zhvillimi ekonomik si dhe çështje të tjera bashkëkohore në mbarë botën. Dita Botërore e Habitat-it festohet në mbarë botën që nga 1986. Është aktivitet që mbahet në të Hënën e parë të Tetorit, ku çdo vit tema kryesore që i adreson sfidat kryesore të kohës ndryshon dhe që vendoset nga UN-HABITAT-i.

Rudina Qerimi,

Zyrtare në UN-HABITAT/ MuSPP

ASAMBLEJA E PËRGJITHSME E KB-SË E EMËRON JOAN CLOS SI DREJTOR TË RI EKZEKUTIV TË UN-HABITAT-IT



Në Mbledhjen e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Joan Clos emërohet Drejtor Ekzekutiv i UN-HABITAT-it në nivelin e nënsekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Ai pritet që mandatin e tij katërvjeçar ta fillojë që nga 18 Tetori. Tish/kryetari i Barcelonës, Joan Clos, ka karrierë të gjatë në Qeverinë Spanjolle, si në nivelin qendror dhe atë lokal. Në periudhën ndërmjet viteve 2006 dhe 2008, ai u emërua Ministër i Industrisë, Turizmit dhe Tregtisë në kabinetin e Presidentit José Luis Rodriguez Zapatero. Më herët, mes viteve 1997 dhe 2006, Joan Clos shërbeu në dy mandate si Kryetar i Barcelonës. Momentalisht është ambasador i Spanjës për Turqi dhe Azerbejxhan. Me të kuptuar këtë lajm, Joan Clos theksoi se është i nderuar që është emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së si Drejtor Ekzekutiv dhe e falenderoi Sekretarin Gjeneral të KB-së, Ban Ki-moon për nominimin e tij. Do të jem mjaft i përkushtuar në detyrën time

të re dhe pres që t'i vazhdojë të arriturat e paraardhëses sime, Anna Tibaijuka. Unë besoj në qytetet e qëndrueshme që e praktikojnë qeverisjen urbane me pjesëmarrje, që siguron strehim dhe shërbime elementare për të gjithë," tha ai. "Më shumë se gjysma e popullsisë sot jeton në qytete dhe me këtë duhet t'i japim prioritet uljes së varfërisë urbane dhe qëndrueshmërinë mjedisore, sidomos tani kur më shumë se një miliard banorë jetojnë në lagjet e varfëra. Përmes bashkëpunimit dhe partneritetit me qeveritë, autoritetet lokale, organizatat joqeveritare, sektorin privat dhe me të gjithë partnerët e Agjendës së UN-HABITAT-it, zonat urbane do të jenë të qëndrueshme si në anën mjedisore, ekonomike dhe sociale. Pres që ta japë kontributin tim modest për të ardhmen e qyteteve."

Burimi: www.unhabitat.org

TAKIMI ME SFIDAT URBANE TË SHEKULLIT 21

Dy dekadat e ardhshme të shekullit 21, do të jenë moment i paparë për historinë e njerëzimit. Popullata botërore do të rritet në zonat urbane nga 50 në 70 për qind. Ky tranzicion që kryesisht ka të bëjë me botën urbane, është i pakthyeshem dhe sjell me vete ndryshime të pakthyeshme në mënyrën e shfrytëzimit të tokës, ujit, energjisë dhe resurseve natyrore. Ky tranzicion poashtu i vë qytetet në qendër të agjendës së ndryshimeve klimatike. Me mbi gjysmën e njerëzimit që jeton në zonat urbane, qytetet konsumojnë më shumë se 80 përqind të energjisë së përgjithshme globale, gjenerojnë më shumë se 70 përqind të mbeturinave dhe kontribuojnë në mbi 60 përqind në emetimin e gazrave. Në të njëjtën kohë, qytetet janë viktimat primare e ndryshimeve klimatike. Shumë nga metropolet e mëdha botërore janë qytete bregdetare dhe rrezikohen nga përmblytjet dhe erozioni; shumë qytete tjera janë të vendosura në zona të thatësisë dhe janë duke u përballur nga mungesa e ujit. Këta janë dy skenarët bazikë për të ardhmen afat shkurtër deri te ajo afatmesme. Qyteteve që u mungojnë burimet e nevojshme dhe prioritetet politike dështojnë t'i përmbushin nevojat e botës urbane. Më pak se një

gjeneratë, rreth dy miliard njerëz përfunduan në shtëpi jashtë standardeve dhe në vendbanime joformale. Shumë njerëz që jetojnë në zona me planifikim të dobët, jetojnë me mungesë të banimit adekuat dhe të shërbimeve elementare. Shumë nga këta banorë që do të njihen si qytetarë urbanë do të punojnë në ekonominë joformale. Akoma më pak do të ketë nga ta që do t'i realizojnë potencialet e tyre. Skenari i dytë, është ai kur sfida urbane rritet mbi politikat publike, dhe përputhet me investimet publike dhe private në zhvillimin e mençur urban. Kjo e nënkupton përdorimin e tokës në mënyrë racionale dhe rigoroze, përmes infrastrukturës urbane dhe shërbimeve elementare dhe shfrytëzimit të plotë të teknologjisë për uljen e pasojave ekologjike. Paradigma e re ka të bëjë me qytete më të gjelbëra, më elastike dhe më të përshtatshme për banim, si dhe krijimi i vendeve të punës dhe mundësive për biznes që ofronjë punë dhe jetesë të mirë dhe largon miliona njerëz nga varfëria. Pasojat sociale, ekonomike dhe mjedisore të skenarëve të lart përmendur janë të qarta dhe të thjeshta për t'u kuptuar. Filmat Qyteti i Zotit (Amerika Latine), Kopshtari i përhershëm (Afrika) dhe Slum Dog Millionaire (Azia) ofrojnë

paraqitje të shkurtër të realitetit social në terren, derisa New Orleans para Uraganit Katrina shërben si përkujtues i zymtë për një strukturë konstante të opsioneve e politikave, mjeteve dhe veprimeve praktike. Në të njëjtën kohë, me qindra qyteza dhe fshatra, secila në mënyrën e tyre ndeshen se si ta menagjojnë procesin e urbanizimit, karshi shtrirjes urbane, shkatërrimit urban, ngushtimit të qyteteve por edhe të rritjes së vendbanimeve joformale. Qeveritë që i promovojnë politikat nacionale për marrjen e veprimeve komunale dhe lokale për urbanizëm të qëndrueshëm është në rritje. Por, përpjekjet e tyre, në të shumtën e rasteve mbesin të pjesshme. Qindra, ndoshta edhe mijëra organizata vendosin precedentë, zhvillojnë mjete dhe ofrojnë opsione politikash që kanë të bëjnë me sfidat urbane. Puna e tyre nuk është e prezentuar siç duhet dhe ndikimi kolektiv i veprimeve të tyre nuk realizohet siç duhet. Më shumë se herave tjera, këto janë arsyet kryesore se pse Kampanja Urbane Botërore është aq e nevojshme dhe e rëndësishme.

Burimi: www.unhabitat.org

PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE

PËRMIRËSIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËRMES PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

Si organizëm i gjallë i cili duhet të rritet krahas nevojave të banorëve të tij, qyteti ose një pjesë e qytetit, kërkon mekanizma dhe mjete të cilat mundësojnë kontrollin e zhvillimit dhe zgjerimit të tij. Këta mekanizma duhet të kenë gjithmonë në konsideratë zhvillimin socio-ekonomik të vet zonës dhe cilësinë e jetës së banorëve të qytetit.

Sipas Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor të Kosovës, këta mekanizma janë Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), Plani Zhvillimor Urban (PZHU) dhe Plani Rregullues Urban (PRU), në përputhje me Planin Nacional Hapsinor (Plani Hapësinor i Kosovës). Implementimi i PZHK/PZHU është hapi i fundit i procesit të planifikimit strategjik, në të cilën strategjitë e planit, politikat, prioritetet dhe vizioni vihen në veprim. Kjo, në shumicën e rasteve, realizohet përmes Projekteve Investive Kapitale (PIK), të identifikuar nga vizioni i PZHK/PZHU-se. Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal - faza 2 (MuSPP2), UN-HABITAT-i në Kosovë, në bashkëfinancim me komunat, nëpër qytetet e ndryshme të Kosovës, kanë zhvilluar PIK të ndryshëm, duke adresuar çështje dhe tema të ndryshme, por gjithmonë në përputhje me PZHK dhe PZHU. Lista në vijim prezanton temat e PIK të cilat janë në zhvillim e sipër:

Tema	Qyteti
Zhvillimi i Infrastrukturës shkollore	Mitrovica, Junik
Menaxhimi i lëvizshmërisë dhe transportit	Mitrovica, Junik, Prizren, Hani i Elezit
Mbrojtja e vlerave Historike dhe te trashëgimisë	Prizren
Shndërrimi i zonës industriale në hapësirë publike	Hani i Elezit
Përmirësimi i hapësirave pranë ujërave dhe hapësirave publike.	Peja, Mitrovica
Menaxhimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe katastrofave natyrore	Ferizaj, Gjilan
Revitalizimi i degëve të lumenjve dhe korridoreve të gjelbra	Mitrovica

Ashtu siç paraqet lista e sipërme, PIK-ët në qytetet e Kosovës janë të zgjedhura kryesisht në hapësirat publike (sheshet, përgjatë ujërave, vijat e lëvizshmërisë, peizazhet, vijat transportuese dhe zonat e trashëgimisë) ose hapësirat e shfrytëzuara nga publiku (oborret shkollore, vlerësim i katastrofave dhe rreziqeve, shndërrimi i zonave industriale në sfera publike, korridore të gjelbra dhe brigje të lumenjve). Qëllimi kryesor i kësaj është të revitalizojë pjesë të zonës urbane të shfrytëzuara nga banorët, duke bërë rrugët dhe hapësirat publike më të gjalla dhe të përshtatshme për këmbësorë. Megjithatë, tendenca e zhvillimit të PIK nuk është që vetëm të përmirësojë, revitalizojë ose mbrojë zonën e qytetit, por të angazhojë partnerët komunal në metoda të reja të planifikimit gjithpërfshirës, pjesëmarrjen aktive të komunitetit, ndërtimin e kapaciteteve të stafit komunal që të zhvillojnë

dhe menaxhojnë në mënyrë të drejtë PIK në të ardhmen. Moto e të gjitha PIK është "fillimisht mendojme në njeriun" dhe është i bazuar në parime të thjeshta:

- Përdorimin e hapësirës së jashtme publike si katalizatorë për zhvillimin e zonës së qytetit.
- Ndërtimin e lidhjes ndërmjet lagjeve, hapësirave përgjatë ujit, dhe veçoritë peisazhore
- Ndërtimin/zhvillimin e përparësive ekzistuese të zonës, si p.sh ripërdorimin e përmirësuar të strukturave të trashëgimisë dhe theksimin e kontekstit natyral gjeografik të qytetit



Figura 1: PIK-u i Hanit të Elezit



Figura 2: PIK-u ne Ferizaj

(elementi socio-kulturor)

- Shndërrimin e të jetuarit në qytet sa më tërheqëse, duke filluar me përmirësimin e rrugëve, dhe inkurajimin e investimeve private (zhvillimin e shfrytëzimit të tokës dhe menaxhimin)

- Gjenerimin e tregëtise dhe aktiviteteve komerciale brenda lagjeve të llojllojshme (rritja ekonomike)
- Trotualet më të gjera dhe më të sigurta
- Më shumë drunj me bulevarde të gjelbra të vazhdueshme
- Qasje e plotë për të gjitha moshat dhe grupe të shfrytëzimit (p.sh. Implementimin e kodit urban të Brejlit si dhe standardeve tjera për qasje)
- Shtylla (poste) më të mira të ndriçimit
- Përmirësimi i rrugëve duke përfshirë trajtim të veçantë në nyjëllore
- Përforsimin e karakterit ekzistues me përdorimin e temave të dizajnit, dhe pasurimin e hapësirave publike me art publik

Të përfshirë në listën të PIK të hulumtuar dhe zhvilluar në qytete të ndryshme Kosovare, aktualisht tre prej tyre janë zhvilluar në projekt propozime të detajuara, kurse një prej tyre është në fazën e punëve ndërtimore. Ato janë kryesisht projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin e punëve të përmirësimit, të cilat zhvillohen në ndërthurje me punë ndërtimore tjera në rrugë. shih fq 7

Lista e PIK the faza e gjendjes së tyre:

1. Pejë – Sheshi Skënderbe – duke u punuar
2. Prizren – Revitalizimi i rrugës së “Farkatarëve” – duke u punuar
3. Mitrovicë - PIK i dytë – “Lumi Lushta – Korridor i Gjellbër” - aprovuar
4. Mitrovicë – Përmirësimi i qasjes për në shkollën fillore “ Meto Bajraktari” - finalizuar
5. Junik – Përmirësimi i oborrit shkollor – duke u punuar

Fadil Dalipi and Jillian Bywater,
Zyrtarë të MuSPP/ UN-HABITAT



Figura 3: PIK-u i Prizrenit

VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE DHE FATKEQSIVE (VMRF)

Fatkeqësitë natyrore ose ato të nxitura nga njeriu, shkaktojnë dëme serioze për funksionimin e komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi. Këto fatkeqësi mund të sjellin humbje të natyrës njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore. Fatkeqësitë shkaktohen nga faktorët natyrorë (tërmetet, përmytjet, erozioni, rrëshqitjet e dheut, zjarret në pyje, cunami, dhe ciklonet/uraganet orteqet, rrymat e nxehtëta dhe të ftohta), ose të nxitura nga njeriu (ndotjet e ajrit nga industria, katastrofat nukleare, kontaminimet e tokës dhe ujit, shterija lumejeve, tokat e minuara).

Pas vitit 1999, Kosova përfundoi një zhvillim të furishëm përkundër faktit se shumica e komunave nuk kishin Plane Zhvillimore Komunale dhe Urbane (PZH/PZHU), të cilat do të shërbenin për qëllim të kontrollimit të duhur të zhvillimit. Si rezultat i kësaj, në disa raste vendbanimet janë ndërtuar në zona me rrezikshmeri të lartë. Si rrjedhojë, Gjilani shtrihet në një zonë me të ndjeshme sizmike në Kosovë, ndërsa Ferizaj shtrihet në zonë të rrafshët (hapsirë e ndikuar nga vërshimet). Të dyja këto komuna kanë shprehur shqetësimin e tyre se si, në mënyrë të denjë, t'i trajtojnë politikën e VMRF-së në PZH/PZHU, me qëllim të trajtimit të kësaj çështjeje. Përmes diskutimeve për bashkëpunimin, në mes të UN-HABITAT/MuSPP dhe komunave në Kosovën Juglindore (Gjilan dhe Ferizaj), këto komuna kërkuar prej MuSPP-it t'i mbështesë në vlerësimin e Planeve Zhvillimore Komunale dhe atyre Urbane. Si rezultat i kësaj, u krijua ekipa për vlerësimin e dokumenteve të PZH/PZHU-së, ekupe e përbërë nga stafi komunal dhe ai i UN-HABITAT-it. Vlerësimi rezultoi me nevojën e plotësimit të PZH/PZHU-së me VMRF, komponent që nuk ishte

trajtuar si duhet në dokumente. Aktivitetet e ndërmarra nga VMRF kishin të bëjë me: ekzaminimin e ligjeve dhe praktikave të VMRF-së në Kosovë; mbledhjen dhe formulimin e Bazës Informative të Planifikimit për analizat e VMRF-se; ofrimin e trajnimit për homologët në këto dy komuna, imlementimin e hulumtimeve të fatkeqësive; formulimin dhe implementimin e pilot projekteve të VMRF-së, si dhe hartimin e politikave të VMRF-së për plotësimin e PZH/PZHU-së. Gjatë 2009, UN-HABITAT/MuSPP-i dhe komuna ndërmorën një hulumtim në terren, për identifikimin e zonave të rrezikuara nga vërshimet, në Gjilan përgjatë lumit Stanishorka dhe në Ferizaj përgjatë lumit Nerodime. Hulumtimi pasoi me formulimin e një baze të dhënash, ku këto të dhëna më pas u analizuan. Rezultatet e hulumtimit treguan për dëmtime të objekteve dhe të të mirave materiale, si pasojë e vërshimeve kronike. Bazuar në karakteristikat gjeo-tektonike të komunës së Gjilanit, në veçanti në zonat urbane dhe densitetit të lartë, komuna kërkoi që të ndërmerret një hulumtim në terren, me qëllim të vlerësimit të ndeshmërisë së ndërtesave publike ndaj temeteve, në veçanti, të objekteve shkollore dhe të identifikohet një objekt shkollor i cili më pas do të përforcohet. Nga kjo u hartuan dy pilot projekte: Njëri nga projektet, për përforcimin e ndërtesave, u inicua në Gjilan. Dhjetë objekte shkollore u përzgjedhën, derisa studimi inxhinierik u udhëhoq nga konsulentët e Institutit për Inxhinieri Sizmike nga Shkupi, të cilët e vlerësuan ndeshmerinë e këtyre dhjetë objekteve shkollore dhe në fund e përzgjedhën, për përforcimin struktural, njëren nga objektet shkollorë. Përzgjedhja e objektit shkollor për përforcim u bë gjatë rekomandi-

meve të konsulentëve dhe diskutimit në mes të palëve të përfshira në këtë proces. Një pilot projekt për reduktimin e vërshimeve në Ferizaj po ashtu u formulua. Gjatë këtij procesi janë organizuar disa takime me komunitetin. Kjo pastaj pasoi me studimin e hidrologjisë inxhinierike, ku edhe u përzgjedh zona për implementimin e projektit. Koncepti dizajnit të projektit, u përzgjedh përmes punëtorive me komunitetin. Këto pilot projekte, si pjesë e VMRF-së do të jenë shembuj se si të trajtohen çështjet e VMRF-së. Politikën e VMRF-së për PZH/PZHU-në, për të dy komunat e lartpërmendura, do të jetë burim i mirë për kufizimin e shfrytëzimit të tokës në hapsirat e ndikuara nga fatkeqësitë dhe do të jenë bazë që do të ndihmojë në hartimin e planeve rregullative urbane, ku komuna do t'i konsiderojë këto zona të kufizuara. Kodi i duhur i ndërtimit do të aplikohet në zonat me nivel të lartë sizmik. Kurse bjektet publike, të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2002, do të vlerësohen dhe pas këtij vlerësimi kërkohet përforcimi tyre, nese është i nevojshem.

vazhdon në faqe 8



Harta e zonës së rrezikshmërisë nga përmytjet në Ferizaj

VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RREZIQEVE DHE FATKEQSIVE (VMRF)

nga faqja 7

Procesi i përgatitjes së komponentës së VMRF-së dhe të identifikimit të objektit shkollor për përfocim, i ka përfshirë të gjitha palët në këtë proces. Gjatë këtij procesi janë mbajtur një numër i prezantimeve/konsultimeve, me pjesëmarrje të akterëve të ndryshëm dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Pas përfundimit, komponenta e VMRF-së, si pjesë përbërëse e Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane, do të miratohet nga Asambleja Komunale.



Harta e rrezikshmërisë nga tërmetet në Gjilan

**Pren Domgjoni and
Besnik Keka,**

Zyrtarë në UN-HABITAT/ MuSPP

PREZENTIMI I EKSPERIENCËS SË KOSOVËS NË PLATFORMAT NDËRKOMBËTARE

TAKIMI I 6-TË REGJIONAL PËR SHQYRTIMIN E DEKLARATËS SË VJENËS PËR VENDBANIMET JOFORMALE

Takimi i 6-të për shqyrtimin e deklaratës së Vjenës u mbajt prej 3 deri me 4 Qershor 2010 në Budapest. Takimi u organizua nga UN-HABITAT-i zyra e Varshavës në bashkëpunim me Qendrën Regjionale Hungareze për Njohuri Urbane.

Vendet anëtare të Deklaratës së Vjenës respektivisht shtetet e Evropës Jug-Lindore u paraqitën nga zyrtarë të nivelit qendror, ekspertë regjional të nivelit lokal, nga OJQ-të, studiues por gjithashtu edhe ekspertë ndërkombëtarë dhe organizata të ndryshme.

Të arritura kryesore dhe sfidat (që nga Shkurti 2009) u prezentuan dhe u diskutuan për çdo shtet të EJT-së.

Sa i përket integritetit të vendbanimeve joformale dhe grupeve të rrezikuara në praktikë, u prezentuan disa raste studimore, që pasuan me diskutim interaktiv ku u përmendën implementimi, mjetet dhe mësimet e mësuara.

Delegacioni i Kosovës, i përbërë nga përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit), Komuna e Pejës dhe UN-HABITAT-i zyra në Kosovë, u paraqit me Planin Urban Rregullativ për vendbanimin joformal të Zatrës në Komunën e Pejës, prezentuar nga planerët lokal, znj. Vjollca Zatriqi-Shala si dhe z. Shkelqim Daci. Përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës, si pjesë e NALAS-it (Netëorë of Association of Local Authorities in South-East Europe) ishte poashtu prezent. Plani Rregullues



Urban i vendbanimit jodformal të Zatrës, që u hartua "në shtëpi" e demonstroi një shembull të mirë se si të adresohen dhe rregullohen vendbanimet joformale përmes planeve rregullative. Objektivat e planit kanë të bëjnë me rregullimin e pronave dhe ndërtesave ekzistuese, përmirësimin e kushteve jetësore të lagjes dhe së fundmi zgjerimin e qytetit bazuar në Planin Zhvillimor Urban.

Vendet anëtare patën mundësi ta përçjellin prezentimin e Dr. Sasha Tsenkova nga Universiteti i Kalgarit, në Kanada, që kishte të bënte me ngritjen e një sistemi monitorimi për Deklaratën e Vjenës. Diskutimi u fokusua gjithashtu edhe në dokumentin e propozuar për programin regjional për ngritjen e kapaciteteve (orientimet strategjike, aktivitetet, rregullimet institucionale, etj.) si dhe në mbështetjen financiare dhe politike për të vazhduar tutje.

Takimi regjional për Deklaratën e Vjenës ishte një mundësi e mirë për shkëmbimin e përvojave dhe informatave ndërmjet vendeve të EJT-së për situatën ekzistuese në fushën e vendbanimeve joformale, procesin e legalizimit dhe në projektet e ardhshme të planifikuara që kanë për qëllim rregullimin dhe përmirësimin e këtyre vendbanimeve.

Kosova ka rëndësi të madhe për Deklaratën e Vjenës ku merr pjesë në takimet e saj që nga viti 2005. Takimet e rregullta ofrojnë prezentim të të arriturave të vendeve anëtare në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me vendbanimet joformale.

Gloriosa Hisari,

Asistente në UN-HABITAT/ MuSPP

PROCESI I PZHK-SË SË JUNIKUT PREZANTOHET NË KONFERENCËN E REAL CORP-IT NË AUSTRI



Përfaqësues të Programit të UN-HABITAT-it në Kosovë, Komuës së Junikut, CHWB-së dhe Institutit për Planifikim Hapësinor morën pjesë në Konferencën e 15-të Ndërkombëtare 'Planifikimi Urban dhe Zhvillimi Regjional në Shoqërinë e Informacionit', që e trajton çështjen e 'QYTETEVE për të GJITHË': të banueshme, të shëndetshme dhe prosperuese që premtojnë vizion dhe fantazi joreale?'. Konferenca u mbajt në Vjenë (Austri) nga 18-20 Maj 2010, ku morrën pjesë një numër i madh i profesionistëve dhe përfaqësues të sektorit operativ privat, publik dhe vullnetar nga mbarë bota. Gjatë kësaj kohe u prezentuan gjithsej 189 prezantime derisa punëtorja tre-ditore u nda njëkohësisht në katër sesione gjatë konferencës. Kjo konferencë në të shumtën e kohës iu adresua çështjes së a janë qytetet të banueshme, të shëndetshme dhe të prosperuese për të gjithë. A është ky një vision premtues për të cilin duhet të punojmë të gjithë, apo kjo është një fantazi joreale? A është e mundur të mirëmbahen

dhe përmirësohen përparësitë e qyteteve dhe të ulen efektet negative? Cilat janë mundësitë dhe kontributet e planifikimit urban dhe zhvillimit të pasurive të patundshme? Si mundet që Teknologjia Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë urbane, të transportit dhe ato mjedisore të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës në qytete? MuSPP-i dhe përfaqësuesit e Komunës së Junikut më herët e kanë dorëzuar një studim për këtë konferencë më të cilin shjellohet metodologjia e zakonshme e punës së zhvillimit "në shtëpi" të Planit Zhvillimor Komunal të Junikut, që është në linjë me temën e konferencës 'Metodat dhe mjetet e avancuara analitike dhe të planifikimit'. Prezantimi u fokusua në zhvillimin e metodologjisë së politikave "në shtëpi" që rezultoi me ngritjen e kapaciteteve komunale, ritjen e pronësisë të këtij dokumenti, perspektivën më të mirë për zbatim si dhe në kosto financiare më të ulët. Gjatë prezantimit të shkëmbimit të përvojave, përfaqësuesit e vendeve fqinje me Kosovën, i dhanë komentet dhe mendimet

e tyre duke u bazuar në ngjajshmërinë me punën e përditshme të cilën e bëjnë çdo ditë. Prezantimi i eksperiencës së Kosovës në platformën ndërkombëtare dëshmoi edhe një herë se shumë çështje janë të përbashkëta në rajon, prandaj shkëmbimi i eksperiencave dhe bashkëpunimi profesional shihet si një nga mjetet më të suksesshme në metodat bashkëkohore të planifikimit. Në përfundim, është e kuptueshme se qytetet janë shumë të ndërlikuara dhe sigurisht se kjo konferencë ngriti shumë pyetje të cilat kërkojnë përgjegjëje. Megjithatë, është e rëndësishme që çështjet me të cilat merren planerët çdo ditë, u diskutuan nga profesionistët e kësaj fushe, derisa RealCorp e ofroi vetëm një vend për profesionistët e kësaj fushe të takohen, të diskutojnë dhe të mësojnë nga njëri tjetri. Më shumë informata të detajuara në lidhje me këtë konferencë, mund të gjenden në linkun në vazhdim:

<http://programm.corp.at/cdrom2010/en/proceedings.html>

Dukagjin Bakija

Zyrtar në UN-HABITAT/ MuSPP

FORUMI BOTËROR URBAN

Brenda disa vitesh, Forumi Urban Botëror është bërë konferenca më e rëndësishme në botë për qytetet.

Forumit është themeluar nga organizata e kombeve të bashkuara me qëllim që të studiojë një nga problemet më urgjente me të cilat ballafaqohet bota sot: urbanizimin e shpejtë dhe ndikimin e tij në komunitet, qytete, ekonomi, ndërrimet klimatike dhe politikat relevante.

UN-HABITAT-i si organizatë lidere e kësaj ngjarjeje, organizoi bienalen e 5-të të Forumit Urban nga 22-28 mars, 2010. Sipas statistikave afro 14000 njerëz nga 150 shtete morrën pjesë në ngjarjen e këtij viti e cila u mbajt në Rio de Janeiro në Brazil. Titulli i këtij viti ishte "E drejta për qytet: Të lidhim ndarjet urbane". Kjo do të thotë që të gjithë njerëzit duhet

të kenë të mundësi të barabarta në qytet, pa marrë parasysh gjininë, etninë apo moshën, dhe se dallimi në të ardhura duhet të reduktohet. Dialogu, debatet e hapura tematike, rrjetëzimi dhe ngjarjet trajnuese, prezantimet e ndryshme, tryezat e rrumbullakëta, asamblëtë gjinore dhe të rinjve u mbajtën paralelisht që ta hulumtojnë këtë temë.

Në forum ishin 140 ekspozita duke përfshirë ato nga organizatat ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare si dhe profesionistët urban. Ata shfaqën misionet dhe të arriturat e tyre sa i përket vendbanimeve joformale në vendet në zhvillim.

Gjatë kohës sa u mbajt forumi ishte mundësia të merrje pjesë në shëtitjet në Favela, gjë që mundësonte të vizitonim këto vendbanime joformale

dhe vizitat organizoheshin nga komuna e Rio de Janeiro. Shëtitja jonë u bë në një Favela të përmirësuar. Në vendbanim komuna kishte të angazhuar një grup të vogël të arkitektëve të cilët u ndihmonin banorëve me ndërtim dhe përgatitjen e vizatimeve për dhënie e lejeve të ndërtimit, pasi që vendbanimi kishte të aprovuar planin rregullues urban. Në ceremoninë përmbyllëse, qeveria e Bahreinit u prezantua si mikpritës i edicionit të gjashtë të Forumit Urban Botëror.

Drejtori ekzekutiv i UN-HABITAT-it znj. Anna Tibaijuka e përfundoi forumin duke na kujtuar të gjithë neve kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm, "që ne duhet të mendojmë se çfarë të ardhme duam t'ua lëmë gjeneratave që vijnë.

Caroline Johansson,

Zyrtare në UN-HABITAT/ MuSPP

PËRVOJAT E PRAKTIKANTEVEVE NË PROGRAMIN E MUSPP-IT

E dashura Lydia,

Siç e din, unë jam në Kosovë për të bërë praktikë si planere në UN-HABITAT. Unë gjithmonë kam dashur të kthehem në Kosovë, vend të cilin e kam vizituar para pesë viteve, ku edhe u inspirova që të vazhdojë me planifikim, prandaj të kthehesha dhe të punosh si planere është e mahnitshme. Prishtina vazhdon të jetë një qytet i nxehtë dhe me pluhur siç e kujtoja, edhe pse shihen përmirësime dhe duket kosmopolitane. Ata përgatisin kafe të mirë të quajtur Makiato. Pejën e paramendova të vogël, dhe më pak të zhvilluar se që është. Kam dëgjuar se një pjesë e saj është shkatërruar nga lufta. Për mua ishte një befasi e vërtetë

të vije dhe ta gjeje një qytet të vogël me restorane të mira dhe shumë dyqane. E gjeta një banesë që kishte një pamje të bukur të maleve të Rugovës dhe (për befasinë time) një disko balkanike poshtë saj! Tani më jam mësuar. Zhurma nga diskoja, minaret dhe lehjet e qenve endacakë janë muzika kryesore e Pejës. Një gjë që më ka çuditur ishte siguria ime gjatë natës, më sigurt se në Manqester. Njerëzit janë shumë miqësorë, cdo mëngjes gjatë rrugës për në punë ka njerëz që më përshëndesin, ku shpesh mendoj se jetoj më gjatë aty, dhe jo vetëm për dy javë. Puna ime është shumë interesante; pothuajse më së shumti

kam punuar në propozimin për Projektin Investues Kapital. Ditët e fundjavës më së shumti i kam kaluar duke ecur maleve që janë shumë të bukura, apo duke i vizituar vendet fqinje si Greqia apo Mali i Zi. Do të doja që përsëri të kthehesha që të punoja e të qëndroja në këtë vend.

Shihemi së shpejti,

Vikki Drummond,

*praktikante e MuSPP-it në Pejë,
Korrik - Gusht 2010*

E dashura mike

Kam mbërritur në Prishtinë me 5 Qershor me pak njohuri për shoqërinë dhe kulturën (tjetër në krahasim me informacionin e kufizuar në internet). Duke mos e ditur se si do të jetë, unë vendosa ta pres të papritshmen. A mund ta imagjinosh se si u lehtësova kur e kuptova se Prishtina nuk është mbrapa nga vendet që i kam vizituar. Gjatë fundjavës time të parë këtu, u mundova ta formoj një përshtypje për çështjet e transportit, në përgatitje për punën që do ta bëjë më tutje. Në përpjekje për të lëvizur nga njëri vend te tjetri, në përpjekje për t'iu shmangur veturave në lëvizje dhe gërshetimin e rrugës nëpër makinat e parkuara në trotuar – ishte një sfidë! Duke e kaluar rrugën e pa sinjalizuar me shpejtësi edhe vendkalimi për këmbësorë ishte afër, që një akt tjetër në të cilin kalova. Vizita ime e parë ishte në Ferizaj, në ditën time të tretë të punës. Ky ishte vendi në të cilin ishte e bazuar puna ime më e madhe. Ishte vend i këndshëm, me një shesh të bukur dhe me rrugica të vogla. Edhe pse më pak njohuri, kjo do të ishte njëra ngë

pesë vizitat e mia të detajuara në Ferizaj. Tash, që kanë kaluar gjashtë javë duke i vështruar hartat e qytetit, duke e analizuar rrjetin dhe kualitetin e sipërfaqeve të rrugëve, unë ndjej se mund të lëviz rrugëve të Ferizajt, pothuajse me sy të mbyllur!

Duke e ndjekur rrugën e "Culture Tour 2010" nga Loyola deri në Mamushë ishte një aventurë. Ne e ndiqnim këtë rrugë ulur në xhipin e UN-HABITAT-it duke i përdorur GPS pajisjet dhe duke e ndjerë çdo gropë me qëllim të gjetjes së rrugës se nga do të kalohet. Gjatë rrugës kishte vreshta, lopët e shuanin etjen e tyre në lum dhe një urë shumë e vjetër që lëkundej nga pesha e një quni që kalonte mbi të. Argëtimi përfundoi kur xhipi u prish në Mamushë. Pastaj ne "u shpëtuam" dhe u bartëm në Prizren, një qytet i bukur në juglindje dhe pastaj në Dragash, një vend rural i vogël i shtrirë në male. Gjatë praktikës, morra pjesë në takime më formale siç ishte Takimi i stafit të MuSPP2 në Gërmi(një park i bukur në periferi të Prishtinës), dhe takimi Tre-palësh me Sida-n. Më pëlqeu prezantimi për Projektet Investuese

Kapitale që janë kompletuar ose ato që vazhdojnë. Isha poashtu e interesuar të dëgjoja për çështjet që janë ngritur dhe të merrja pjesë në diskutimin e masave që duhet të ndërmerren që këto çështje të zgjidhen. Duke qëndruar në zyrën në Prishtinë, në javën e fundit të praktikës, e pyes veten se çka kam mësuar, çka kam kontribuar, dhe si do të duket Kosova në dhjetë vitet e fundit... Unë ndjej se kam mësuar shumë, por efekti nuk do të shihet deri sa të mbërrim në Dublin dhe e tëra të vihet në perspektivë. Unë nuk jam e sigurt nëse kontributi im në studim do të jetë frytdhënës, por sigurisht shpresoj se do të jetë. Për Kosovën mendoj se ka shumë potencial dhe që hapat e drejtë janë ndërmarrë përmes punës së shumë organizatave dhe programeve dhe njëri nga ta është edhe MuSPP2. Besoj se Kosovës i duhet kohë për arritjen e qëllimeve, por në këtë rast vlenë siç jemi mësuar të thomë, "Roma nuk është ndërtuar për një ditë".

Të fala,

Jean Ryan,

praktikante e MuSPP-it në çështjet e transportit dhe mobilitetit

E dashura Fiona,

Shpresoj se jeni mirë dhe çdo njëri i kthyer në shtëpi po kalon mirë. Kam dëgjuar se moti në Sydney është shumë i mirë! Moti në Prishtinë është shumë ndryshe nga ai që jam mësuar – këtu bie borë pothuajse që një javë! Bora nuk qëndron edhe gjatë, por nga bota mbulohet një sfond i këndshëm i peizazhit dhe ndërtesave.

Pothuajse gjatë tërë javës qëndrova në Prishtinë, duke ndihmuar në përgatitjen e raportit strategjik të planifikimit, por të Martën dhe Mërkurën isha me fat të

udhëtoja në disa zona të regjionit. Shefi im i menagjon disa projekte në zyrat që ndodhen në jug-lindje të Kosovës, dhe në këtë mënyrë ne u takuam me stafin dhe më njërin nga kryetarët komunave për të diskutuar për një projekt të përmirësimit të një ndërtese publike. Gjëja e parë që më ra në sy ishte shpejtësia e arrijtes nga njëri regjion në tjetrin. Rrugëtimi në pjesën juglindore ofronte pamje të tokave bujqësore, fushave të mbuluar nga uji dhe fshatrave të vogla përgjatë rrugës. Ishte një pamje e veçantë e majave të maleve mbuluar me borë, që

udhëtimin tonë ia jipte një ngjyrë të bukur. Tash jam në Prishtinë, dhe pres që të takohem me disa miq nesër mbrëma në qytet. Nuk jetoj edhe shumë larg nga qendra e qytetit, por për çdo rast, qyteti është i vogël dhe është mirë të jesh në gjendje të ecësh! Megjithkëtë, shpresoj se gjërat janë mirë në shtëpi. Do të flasim së shpejti!

Me dashuri,

Yi-Juan Koch,

praktikante e MuSPP-it në Zyrën Regjionale Jug-Lindje

TURNËU KULTUROR '10



Më shumë se 300 ciklistë iu bashkuan Turneut Kulturor 2010 të Dielen, me 19 shtator. "Turneu Kulturor" organizohet në kuadër të Javës Evropiane të Mobilitetit dhe Ditëve të Trashëgimisë Evropiane duke e promovuar mobilitetin e qëndrueshëm dhe në të njëjtën kohë trashëgiminë kulturore të Kosovës, në një atmosferë unike e festive.

Këtë vit, Turneu Kulturor u nis nga Prizreni, dhe u organizua në kuadër të Javës Evropiane të Mobilitetit nën moton: "Lëviz me mençuri, jeto më mirë".

Çiklistët u argëtuan nga performancat e vallëzimit në sheshin e ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit në ditë me diell, për të vazhduar më pas me ngasjen e bicikletave në pjesën e vjetër dhe në qendrën e qytetit, që ishte i mbyllur për trafikun e veturave.

Më pas, i tërë grupi prej 300 vetave, i përbërë nga meshkuj dhe femra nga 6 deri në 60 vjec, u nisën për ta përshkuar rrugën nga Prizreni deri në Mamushë, e më pas për të vazhduar për në Hocën e Madhe, kryesisht në rrugët dytësore, pa lëvizje makinash përkaj fshatrave të vogla, pyjeve, fushave dhe vreshtave. Në Mamushë, vallëzimi vazhdoi, ku të pranishmëve iu ofruan prodhime të freskëta nga arat e tyre, ku ciklistët morrën energji të mjaftuar për ta kaluar terrenin malor nga fshati Retije për në Hocën e Madhe, ku në këtë të fundit u përgatit dreke për të gjithë të pranishmit.

Turneu Kulturor është nismë e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë të UN-HABITAT-it (MuSPP) dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufi(CHWB), të dyja këto të financuara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar(SIDA) dhe mbështetur nga Bashkimi Evropian. Po ashtu pjesë e këtij projekti janë edhe Këshilli i Evropës për "Mbështetje të Promovimit të Diverzitetit Kulturor", Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut dhe partnerë të tjerë lokalë. Turneu Kulturor në edicionet e mëhershme e ka vizituar Pejën, Isniqin, Deçanin, Junikun, Gjakovën dhe Rahovecin, derisa në vitin 2011 do të zbulojë bukuri natyrore dhe kulturore në pjesë tjera të Kosovës, ku ky itinerar më pas të vazhdohet me familje dhe miq.

Rudina Qerimi,
Zyrtare në UN-HABITAT/ MuSPP

STAFI I MUSPP-IT SHKËMBEN EKSPERIENCAT NË ORGANIZIMIN E "NOMADE IN METZ"



Në organizim të Komunës së Metzit në Francë dhe OJQ-ve "Tabullarasa" dhe Fondacionit Emmaus të Abe Pierre, Festivali "Nomade in Metz" do të mbahet në qytetin e Metz-it, për të dytën herë, nga 10 deri me 19 Shtator.

Me qëllim që festivali të organizohet sa më mirë, organizatorët vendosën që të marrin profesionistë nga jashtë që përveq mbështetjes së tyre në punët preparatore, këtë festival ta pasurojnë edhe me përvoja të reja.

Një reprezentues nga stafi i MuSPP-it ishte njëri nga pjesëmarrësit në përgatitjen e festivalit i zgjedhur nga organizatori, ku angazhimi i tij kishte të bënte me përfshirjen e komuniteteve, me orgasnizimin e fushatës mediale por gjithashtu edhe nw ofrimin e përvojës së tij për gjetjen e donatorëve të mundshëm.

Pas një pune preparatore një mujore të organizimit të "Nomade in Metz" ishte e qartë se përvoja e sjellur nga MuSPP-i në Kosovë ishte shumë frytdhënëse dhe tash pritet që rezultati të shihet në Shtator.

Rëndësia e këtij festivali, që për here të parë u organizua vitin e kaluar është që ta paraqesë komunitetin dhe grupet e ndryshme etnike që jetojnë në Francë. Festivali i përfshin të gjitha format e shprehjes si letërsia, argëtimi në rrugë, muzika dhe vallëzimi, filmat, ekspozitat e fotografive, vizatimet, konferencat por gjithashtu edhe ushqimi dhe kuzhina, në lagje të ndryshme të qytetit të Metzit por edhe jashtë tij.

Festivali i mobilizon profesionistët, asociacionet, shkollat, universitetet, organizatat joqeveritare, bizneset, artistët dhe qytetarët. Vlen të theksohet se ky festival mëton të bëhet tradicional.

Vlen të theksohet se qëllim tjetër i këtij festivali është ta njoftojë komunitetin francez me romët nomadë dhe me jetën e tyre tradicionale, të cilët jetojnë në periferi të qytetit të Metzit.

Astron Mahmutaj,
Asistent në UN-HABITAT/ MuSPP

Edicioni i ardhshëm

- KONFERENCA MBI VIZIONIMIN SI MJET I PLANIFIKIMIT PJESMARRËS
- SHPALLJA E SHQYRTIMIT PUBLIC TË PZHK-SË SË JUNIKUT
- NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT ME MAMUSHËN
- SHKËMBIMI I MARRRËVESHJEVE TË BASHKPUNIMIT ME HANIN E ELEZIT
- CEREMONIA E HAPJES SË PROJEKTIT PËR SHKOLLË TE SIGURTE, PIK – U NË MITROVICË

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

MuSPP 2 është faza e dytë dhe më e avancuar e Programit të mbështetjes së planifikimit hapësinor komunal. Koncepti i tij është zhvilluar me komunat partnere në mënyrë që të sigurojmë konsolidimin e aktiviteteve të planifikimit të kryera në MuSPP1. Dizajni i programit është konsultuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe Sida-n. Programi adreson nevojën që të forcojmë kapacitetet e autoriteteve lokale dhe zyrtarëve të tyre profesional për implementimin e planeve zhvillimore të zhvilluara gjatë MuSPP1. Gjithashtu lidhet edhe me ekspertizën dhe përvojën ekzistuese në njësitë lokale dhe qendrore, të cilat janë përgjegjëse për aktivitete të planifikimit (p.sh. departamente komunale të urbanizmit, departamenti e planifikimit hapësinor dhe instituti i planifikimit hapësinor në MMPH). Bashkëpunimi në nivel qendror është i fokusuar në adresimin e qështjeve të cilat nuk janë në spektrin e përgjegjësi të kompetencave komunale dhe ku mbështetja e nivelit qendror është themelore. MuSPP2 kërkon kycje më direkte të organizatave të shoqërisë civile në implementimin e programit përmes sistemit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Bazuar në mësimet e mësuara nga përvoja e kaluar, ofrimi i këshillave teknike dhe mbështetja këtë herë është bërë përmes qasjes së bazuar në projekte dhe me orientim kah rezultati.

IMPRESSUM

UN-HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE



Bashkë bëjmë qytete më të mira

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP)

Kryekëshilltare Teknike/
Udhëheqëse e Zyrës/
Krystyna Galezia
krystyna.galezia@unhabitat-kosovo.org

Zyra e UN-HABITAT-it, Kosovë
Ndërtesa e Ministrive "Rilindja"
kati i X-të,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

Më shumë për UN-HABITAT Kosovë:
www.unhabitat-kosovo.org

Më shumë për UN-HABITAT-in
www.unhabitat.org

Editimi: Krystyna Galezia, Rudina Qerimi **Editimi ne gjuhen angleze:** Jillian Bywater
Editimi ne gjuhen shqipe dhe perktimi: Astron Mahmutaj

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes Sida-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet u përkasin autorëve. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën e vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e Sida-s.